

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Rama më shkruan në 1-2 të natës"/ Dashnor Sula rrëfen komunikimin me Kryeministrin: Më dërgon problemet e qytetarëve dhe kërkon përgjigje
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/rama-me-shkruan-ne-1-2-te-nates-dashnor-sula-rrefen-komunikimin-me-kryem-i585238
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 16:35:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 17:25:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	485826a170e66d18356d4922f54f54d37c18149abecab11861ee156901857f9a
TEKSTI	c126102ad9438260ce255d69fce440b174d318ee4a37f0b93654d7090f7c2e3b
PAMJA	675d4db913737e484523d749f9230b95f87f0d47c66b11c5f39e7e04e32059e9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f919aa7b68946fc1845e63940cd78500a47463334952c0c0ce4e007740b03c14
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f919aa7b68946fc1845e63940cd78500a47463334952c0c0ce4e007740b03c14>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e [Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin/ luturime direkte mes Luksemburgut dhe Tiranës/ Ministri Hoxha: Një tjetër kompani ajrore evropiane vjen në Shqipëri/ Accor zgjer](#)
fundit

“Rama më shkruan në 1-2 të natës”/ Dashnor Sula rrëfen komunikimin me Kryeministrin: Më dërgon problemet e qytetarëve dhe kërkon përgjigje

10 Shtator 2026, 19:25Sociale TEMA



“Rama më shkruan në 1-2 të natës”/ Dashnor Sula

Kryeinspektori i Shtetit, Dashnor Sula, foli në Top Channel për sigurinë ushqimore, kontrollet ndaj karburanteve, problematikat me inspektorët dhe komunikimet me kryeministrin Edi Rama.

Duke u ndalur te mishi i importuar, Sula tha se është konstatuar një fenomen ku mishi nga vendet e Amerikës Latine kalonte drejt Kosovës dhe më pas rikthehej në Shqipëri.

“Mishi që vjen nga vendet e Amerikës Latine në Shqipëri e ka taksën 15%, ndërsa Kosova e ka pasur 0. Shkonte në drejtim të Kosovës dhe kthehej si mish nga Kosova, ndërkohë që shitej në tregun shqiptar”, tha Sula.

Ai deklaroi se për këtë çështje janë shtuar kontrollet në pikat doganore dhe janë larguar inspektorë që, sipas tij, bashkëpunonin apo kishin marrëdhënie me subjekte të caktuara. Sula bëri të ditur gjithashtu se më 3 shtator është ndaluar mish i ardhur nga Brazili për shkak të riskut.

Kryeinspektori foli edhe për misrin me aflatoksinë, duke deklaruar se janë larguar nëntë inspektorë pas rasteve të konstatuara në pikën doganore të Hanit të Hotit.

Për karburantet, Sula tha se qëllimi i inspektimeve nuk është ndëshkimi i biznesit për shkelje të vogla, por se masat duhet të jenë të menjëhershme kur preket interesi publik.

“Menjëherë reagohet: bllokimi i pikës së karburantit, marrja e mostrave, pezullimi i aktivitetit, deri në heqjen e licencës”, deklaroi ai.

Sula pranoi gjithashtu se integriteti i trupës së inspektimit nuk është në nivelin e duhur, duke thënë se ka inspektorë që favorizojnë subjekte të caktuara. Ai njoftoi se deri në mars 2027 synohet dixhitalizimi i sistemit, ku subjektet do të përzgjidhen për kontroll sipas nivelit të riskut.

Në studio, Sula foli edhe për marrëdhënien me kryeministrin Edi Rama, duke deklaruar se në gjashtë muaj në detyrë ka pasur “zero ndërhyrje” prej tij për favorizimin e ndonjë subjekti. Ai tha se komunikimi mes tyre është thuajse i përditshëm dhe se Rama i përcjell edhe gjatë natës problematikat që merr nga qytetarët. Fati im si kryeinspektor është që kam një mbështetje të jashtëzakonshme nga Kryeministri Edi Rama.

Dashnor Sula: Dihet si funksionojnë gjërat në Shqipëri, presione etj. Para 1 jave kemi pasur një takim me Kryeministrin e Shqipërisë dhe ai ka qenë konkret. I jam drejtuar drejtpërdrejt: 6 muaj në detyrë e kam pasur 0 ndërhyrjen nga Kryeministri i Shqipërisë për të favorizuar ndonjë subjekt, 0. Të njëjtën gjë e kam bërë me kryeinspektorët rajonalë poshtë.

Pra, ky është standardi që duhet të vendoset, se në momentin që fillon ndërhyrja Kryeministri te Inspektori i Përgjithshëm, Inspektori i Përgjithshëm ndërhyr te kryeinspektori qendror, kryeinspektori qendror te kryeinspektorët rajonalë, kryeinspektorët rajonalë tek inspektorët, u prish sistemi, u shkatërrua.

Sidorela Gjoni: Më përpara mendonit që Rama kontrollonte çdo gjë?

Dashnor Sula: Jo, nuk e thashë atë, nuk e them dhe nuk e di.

Sidorela Gjoni: Më përpara, më përpara.

Dashnor Sula: Nuk e di absolutisht dhe kam bindjen. Pse? Pse nuk e bën me mua?

Sidorela Gjoni: Të habit kjo gjë?

Dashnor Sula: Jo, nuk më habit. Ka qenë një ndër arsytet pse unë pranova sfidën që më drejtoi Kryeministri i Shqipërisë, që lashë kostumin e politikanit dhe veshja kostumin e nëpunësit të shtetit. Ia kam bërë të qartë Kryeministrit që unë me bashkëpunëtorët e mi do të duhet të punoj ashtu siç duhet, në respektim të ligjit dhe të jem korrekt, do të duhet të kem pavarësinë sipas ligjit. Dhe po ju them që kam komunikim thuajse të përditshëm dhe nuk është se jam nga ata që të bëj me dije mesazhet e Kryeministrit, por mbështetjen që më ka dhënë. Po ju them edhe rastet që Kryeministrit të Shqipërisë i ankohen, normalisht se ka informacion për të gjitha gjërat. Ai menjëherë, nuk kalon gjysmë ore, një orë, reagon dhe pret përgjigje si është zgjidhur problemi dhe kjo është shumë pozitive.

Sidorela Gjoni: Është investuar, do të thuash?

Dashnor Sula: Totalisht, po të them pra. E beson që nuk është turp me ta thënë që më është bërë telefoni duke e mbajtur te veshi. Ai në 12 të natës, 1 të natës, të shkruan për problemet që i çojnë qytetarët dhe unë e vlerësoj maksimalisht. Edhe unë reagimin ndaj qytetarëve e kam të menjëhershëm dhe i japim një zgjidhje çdo problematike që ka qytetari. Pra, është shumë e rëndësishme transparenca.

Sidorela Gjoni: Ke nostalgji për kohën si politikan, si deputet?

Dashnor Sula: Tani, 20 vite në politikë, isha 2005-2025 dhe nuk pretendoj që unë kam bërë “uau” në politikë, por mendoj që kam vendosur 2 tulla, duke filluar nga personaliteti im, integriteti im. Nuk është për t’u mburrur, por unë jam nga politikanët që nuk është përfolur 20 vite për afera korruptive, po 0. Dhe këtë ia kam thënë edhe Kryeministrit të Shqipërisë, po ua deklaroj të gjithë qytetarëve shqiptarë: nëse një i afërm i imi, nëse një person i imi, kushdo qoftë, abuzon, jo të ma provojë, i kam thënë Kryeministrit, por të dyshohet ndaj meje apo bashkëpunëtorëve të mi të afërt, jo iki, por hedh çelësat e largohem. Ky është standardi që duhet të vendosim, ndryshe ne nuk rrisim besimin te qytetarët.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Në prag të vitit të ri shkollor, Bashkia e Tiranës masa të shtuara për institucionet arsimore! Në fokus garantimi i procesit të regullt mësimor](#)

18:15 Sociale

[Fermeri shqiptar prodhon specia të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë](#)

17:35 Sociale /5 komente

[Papunësia zbret në 8.3 përqind - INSTAT: Shërbimet udhëheqin punësimin, tkurret për bujqësinë](#)

16:35 Sociale /1 koment

[118 milionë euro për Durrësin - BE dhe Franca financojnë rehabilitimin e kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura](#)

13:15 Sociale /2 komente

[“Afterschool”, falas nga 1 tetori! Lista, cilat janë 85 shkollat e Tiranës?](#)

10:55 Sociale /5 komente

[Legalizimet mbyllen në 2028 / Përgjigje për legalizimet, brenda 30 ditëve. Shkrihen Kadastra dhe Agjencia e Pronave](#)

18:50 Sociale / 8 komente

[Dëmshtëpërblimet nga zjarret, duhet dokumentacion për tokën dhe të mbjellat](#)

16:50 Sociale / 1 koment

[Kurrikula Europiane dhe punësimi i sigurt rrisin me 60% interesin për KPGJT](#)

12:08 Sociale

[Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të angazhuar, Kumbaro në panelin ministror të PISA: Duam më shumë hapësira ku fëmijët mund të shkëlqejnë](#)

10:25 Sociale / 5 komente

[Rama për rezultatet e PISA-s: Shqipëria mori një “dëftesë të jashtëzakonshme”, rezultati më i mirë ndonjëherë](#)

08:45 Sociale / 49 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 16 komente

[VIDEO/ Protestuesit nuk kursejnë as qytetarët, sulmojnë n...](#)

21:12 Politika / 80 komente

[Koinçidenca misterioze e 12 shtatorit, ‘Flamingot’ përpla...](#)

19:20 Blog / 25 komente

[VIDEO/ Thellohet përçarja mes protestuesve, protesta ndah...](#)

20:20 Politika / 36 komente

[Përçarja në protestë, Balla i përshëndet nga Paskuqani pa...](#)

22:10 Politika / 3 komente

Blog Tema

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 5 komente

[Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet](#)

12:38 Blog / 16 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
| <ul style="list-style-type: none">• Kontakt• Te dhënat personale• Cookies | |

Built and Monetized by